

NewsLetter 20 Years



THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

MASAT EKONOMIKE TË NDËRMARRA DHE
AKTET PËRKATËSE NORMATIVE

PLANI FINANCIAR



Në faqen 5

PANDEMIA E COVID-19

Përballja me krizën



AMCHAM PROPOZON ZGJIDHJET Në faqen 2

REZULTATET E PYETËSORIT të Dhomës Amerikane

Dhoma Amerikane në përpjekje për të marrë mendimin e anëtarëve të saj, mbi kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e tyre dhe impakti që ka kjo situatë, organizoi pyetësin, i cili ndihmoi për të ndërtuar një panoramë të qartë të gjendjes në të gjithë sektorët dhe problematikave që ato kalojnë. Ne dëshirojmë të falenderojmë secilin prej anëtarëve që na dha një feedback të vlefshëm për kushtet në të cilat po operon biznesi i tij dhe sektori që përfaqëson. Këto të dhëna dhe statistika do ta ndihmojnë Dhomën Amerikane të orientojë drejt politikave të saj lobuese dhe të formatojë kërkesa të qarta kundrejt Qeverisë Shqiptare.

Për më shumë, ndiqni në 7 faqen 4 reflektimin e anëtarëve të AMCHAM-it mbi çështjet e trajtuara në pyetësor:

**PROBLEMATIKAT E SHPREHURA NGA BIZNESET
ANËTARË TË AMCHAM SIPAS SEKTOREVE TË BIZNESIT:**

SHËRBIME KONSULENCE

Përfaqësues të sektorit të konsulentëve për bizneset ngrejnë problematikat të ndryshme që po hasin gjatë periudhës së izolimit, për shkak të nevojës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID 19. Ata shprehen të shqetësuar, pasi sektori i tyre po përballë me refuzim të pagesave, duke ngritur një zinxhir të mungesës së qarkullimit të likuiditetit, kryesisht si pasojë e rënies së shitjeve si dhe vonësive të pagesave nga klientët.

Në këto kushte, zhvillimi i bizneseve të reja apo

» Vijnë në faqen 4

EKONOMIA NË VËSHTIRËSI

ENIO JAÇO, PRESIDENT I DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË INTERVISTË PËR EURONEWS ALBANIA

ILVA TARE: Cilat janë qëndrimet e anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë, shqetësimet kryesore që kanë me situatën?

ENIO JAÇO: Anëtarët e Dhomës Amerikane janë të shqetësuar. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me ta, në radhë të parë për të kup-

tuar shqetësimet specifike që ka çdo anëtar. Por gjithashtu, për të kuptuar shqetësimet që ka çdo sektor, sepse janë të ndryshme nga një sektor në tjetrin. Në të njëjtën kohë, jemi duke punuar në mënyrë aktive për të ndërtuar propozimet e duhura. Kemi bërë disa propozime dhe po

përgatisim edhe disa të tjera, për t'i komunikuar me Qeverinë dhe për të menaxhuar këtë krizë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që në këtë moment, të gjithë së bashku kemi tre objektiva kryesorë. Në radhë të parë, të shpëtojmë sa më

» Vijnë në faqen 3

COVID 19- ECONOMIC NEWS



» Në faqen 6

10 propozimet e Bashkimit të Prodhuarëve: Pagat të subvencionohen 80%, taksat vendore të shtyhen deri në dhjetor 2020, të ulët çmimi i energjisë

Euro zbrit në 128.5 lekë, pas rritjes artificiale të dy javëve të fundit, por diferenca në shit-bleje mbetet e lartë

Zhvillimi i tregjeve të kapitalit, Pr.Ligji në Kuvend/ Mundësi financimi dhe transparencë në investime

PËRBALLJA ME KRIZËN

AmCham propozon zgjidhjet


COVID-19 është emri më i fundit i krizës ekonomike mbarëbotërore që ka mbërthyer edhe Shqipërinë. Të gjendur të papërgatitur në planet e tyre të biznesit, për një mbyllje kaq drastike që la në mes prodhimin dhe shërbimin e shumë sektorëve, bizneset u përballën egërsisht me pyetjen – si do mbijetojmë?

Anëtarët e Dhomës Amerikane ia kanë drejtuar këtë pyetje organizatës, e cila në ditët e para të situatës pandemike, vendosi të kërkojë nga qeveria një plan konkret masash për t'i ardhur në ndihmë një spektri të gjerë të biznesit.

Plani i rreptë i distancimit edhe pse u përkrah nga AmCham-i, ka krijuar një sfidë të vërtetë në minimizimin e pasojave që rrjedhin prej tij. Ekonomia e paguan e para. Bizneset që janë motorri që zhvillon ekonominë ndien që në ditët e para ngërçin e krijuar prej izolimit.

Në një situatë të paprecedentë si kjo, Dhoma Amerikane inkurajoi qeverinë shqiptare të zhvillojë një plan emergjence të mbështetjes së komunitetit të biznesit, për të parandaluar një krizë të thellë ekonomike që mund të gërryë bazën e shëndetshme ekonomike të vendit.

Dhoma Amerikane beson se në këtë situatë, qeveria dhe biznesi duhet



të bëhen bashkë dhe të mbështesin njëri-tjetrin, si e vetmja formë për të dalë nga një krizë, fundi i së cilës nuk duket akoma. "Ne duhet të punojmë të gjithë bashkë, për të identifikuar dizenzimin e zgjidhjeve më të mira, në mënyrë që të

minimizojmë efektet negative afatgjata mbi komunitetin e biznesit, dhe më gjerë akoma, mbi ekonominë e vendit"- u shpreh Bordi i Dhomës Amerikane në deklaratën për mediat.

Duke bërë publik mendimin e tyre

PLANI I MASAVE I PROPOZUAR NGA AMCHAM ALBANIA

- » Kërkesë për shtyrjen e afatit ligjor për:
 - Depozitim të pasqyrave financiare;
 - Formularit për Deklarimin dhe Pagesën e tatimit mbi fitimin, si dhe;
 - Njoftimit vjetor për transaksionet e kontrolluara.
- » Eliminimin e detyrimeve fiskale për të paktën tre muaj, ndërsa për bizneset në sektorin e turizmit gjashtë muaj
- » Krijimin e një fondi të emergjencës që do të mundësojë akses në kapital (me anë të kredive të buta si dhe granteve), në mënyrë që bizneset të përballojnë efektin negativ të kësaj periudhe

mbi gjendjen dhe masat që duhet të ndërmerren, drejtuesit e Dhomës Amerikane u shprehën se "Këto nuk janë kohë të zakonshme për biznesin. Politikat qeveritare duhet të orientohen në përputhje me situatat e jashtëzakonshme në të cilat po jetojmë. Ne besojmë se rekomandimet tona do t'i vijnë në ndihmë të gjitha bizneseve, të cilat janë dëmtuar financiarisht, duke i lehtësuar nga detyrimet financiare të detyrueshme në kohë normale".

LAJME ANËTARËSH



CCBS

Coca-Cola Bottling Shqipëria (CCBS), ndërmarrja prodhuese e produkteve të markës "The Coca-Cola Company" në Shqipëri, ka dhuruar në emër të punonjësve të saj, një donacion në vlerën e 6,000,000 Lekëve në favor të Shërbimit Infektiv pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë.

Ky dhurim është një gjest i nevojshëm me qëllim për të ofruar një mbështetje konkrete për të përballuar me mirë këtë emergjencë dhe u bërë mundur, falë sjelljes së përgjegjshme të të gjithë njerëzve që punojnë në CCBS.
- tha Presidenti i CCBS, Luca Busi.

Ne, në Dhomën Amerikane ndihemi krenarë për shembuj të ndihmës dhe të bashkëpunimit që kompani amerikane si Coca-Cola kanë ofruar në ditë të vështira për sistemin shëndetësor shqiptar.




ABI BANK

në mbështetje të klientëve për shtyrjen e kredive

Banka Amerikane e Investimeve ka përkrahur nismën e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i cili vendosi të shtyhen me 3 muaj pagesat e kësteve të kredive për të gjithë klientët e bankave. ABI Bank e vlerësoi nismën si një hap i ndërmarrë në kohën e duhur, për t'i dhënë mundësi klientëve të lenë mënjatë shqetësimin e pagesës së kredisë e të kujdesen për familjen dhe punonjësit e tyre, që në këtë moment është më urgjente.

Ky nuk është momenti të shikojmë se si do të dalim në fund të vitit, por të ndihmojmë klientët me nevoja urgjente.
- u shpreh Drejtori i ABI Bank, z. Andi Ballta.

Dhoma Amerikane falenderon anëtarin e saj për frymën e mirëkuptimit dhe për gatishmërinë për t'u gjendur bizneseve dhe individëve në këtë situatë të vështirë.



ENIO JACO, PRESIDENT I DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË INTERVISTË PËR EURONEWS ALBANIA

» Vijn nga faqja 1

shumë jetë njerëzish. Duket sikur kjo pjesë e problemit po shkon aq mirë sa kemi mundësi të shkojë. Kemi një kurbë të ulët të infeksioneve. Është gjithashtu e rëndësishme të menaxhojmë sistemin shëndetësor, që të mos mbingarkohet e të mos kemi një krizë humanitare.

Por shumë e rëndësishme për ne, gjë për të cilën po punojmë shumë në mënyrë aktive, është që në rrugë e sipër të mos shkatërrohet ekonomia. Këto janë objektivat kryesorë, për të cilat ne po punojmë ngushtë edhe me anëtarët tanë.

ILVA TARE: A keni propozime konkrete ju si Dhoma Amerikane sa i takon masave që duhen marrë dhe ndihmës që duhet të japë Qeveria?

ENIO JACO: Ne kemi bërë tre propozime kryesore. Jemi duke përgatitur edhe të tjera më të detajuara, por në radhë të parë duhet bërë shtyrja e pagesave tatimore. Kjo është diçka që është aplikuar në shumicën e vendeve. Mendojmë që është shumë e arsyeshme.

Kemi propozuar eliminimin e taksës për disa sektorë të caktuar, ata që janë më të prekurit dhe më në nevojë. Dhe ajo që është shumë më e rëndësishme për ne, është krijimi i një fondi emergjence, në mënyrë të tillë që bizneset e prekura, të kenë akses në kapital dhe të përballojnë pagat e punonjësve dhe vazhdimësinë operacionale gjatë një periudhe të caktuar. Ne kemi propozuar që kjo të aplikohet për ato biznese që ruajnë 90 për qind të punonjësve të tyre, pra që ruajnë vazhdimësinë.

Masat duhet të targetojnë dy elementë të rëndësishëm. Zbutjen e paso-



jës, bizneset kanë goditje të madhe gjatë kësaj periudhe. Dhe duhet të sigurojmë një vazhdimësi të likuiditetit për bizneset, në mënyrë që ata të vazhdojnë me detyrimet e tyre, por gjithashtu edhe të ruajnë punonjësit e tyre.

ILVA TARE: Ju zoti Jaco sapo jeni kthyer nga SHBA-ja. E di që shpesh kur bëjmë krahasime me Gjermaninë, Greqinë apo Amerikën në ndihma, na thonë që s'jemi si ata. Por a mund të kemi ndihmë të ng-

jashme? Çfarë plani ka SHBA-ja për të ndihmuar e injektuar ekonominë?

ENIO JACO: Po, mund të kemi një plan të ngjashëm. Në fakt, në një farë mënyre është e parëndësishme se sa e madhe apo e vogël është ekonomia. Ajo që është e rëndësishme, është raporti i stimulit me përmasën e ekonomisë. Pra, raporti i stimulit që do injektujmë me Prodhimin e Brendshëm Bruto.

Masa e artë që ekonomistët rekomandojnë për situatën e koronavirusit është 10-15 për qind e PBB-së. Pra, një masë stimuluese që arrin nga 10-15 për qind e PBB-së. Këtë kanë bërë edhe disa nga vendet me paketën fiskale më

të mirë. Kjo ka ndodhur në Britaninë e Madhe dhe Francë. Por, edhe paketa fiskale prej 2.2 trilion dollarësh në Amerikë është shumë e mirë dhe përfaqëson 10 për qind të PBB-së.

Me llogaritë tona, paketa stimuluese që Qeveria ka propozuar është rreth 2.5 për qind e PBB-së. Ne mendojmë që është e pamjaftueshme.

Jam i bindur se do shkojmë tek faza B, C, D dhe kjo është e kuptueshme sepse është diçka që do rritet në vijim. Ajo që ka funksionuar mirë në Amerikë – arsye pse kanë reaguuar edhe tregjet e aksioneve dhe ekspozitët, por gjithashtu edhe ekonomia ka filluar të ketë shenja të mira – është sepse kjo paketë është e qënësishme, pra e madhe, por edhe është e detajuar. Ka një legjislacion që i përshtatet pothuajse të gjithë sektorëve.

Është shumë e detajuar. Krijon mundësinë dhe jep udhëzimet e duhura për bizneset për të aplikuar. Dhe ajo që është më e rëndësishme, është që ofron një fond të mjaftueshëm likuiditeti pothuajse për çdo biznes. Ofron një fond për bizneset e vogla dhe gjithashtu një për bizneset e mëdha. Kjo është në formë kredie e butë.

Është shumë e rëndësishme që bizneset në këtë periudhë të funksionojnë dhe të kenë akses në kapital, në mënyrë që nëse kjo situatë vazhdon për dy ose tre muaj, të jenë në gjendje të bëjnë pagesa për punonjësit e tyre, në mënyrë që kjo të mos kthehet në rrezik social. Gjithashtu, është e rëndësishme që bizneset të funksionojnë pak a shumë njësoj si më përpara. Pra, është shumë e rëndësishme të kenë akses në kapital. Kjo po funksionon në Amerikë, ndaj tregjet janë përgjigjur pozitivisht.

Rezultatet e pyetësorit të Dhomës Amerikane

» Vijnë nga faqja 1

projekteve është pothuajse i pamundur. Gjithashtu, lëvizja me orare të kufizuara sjell shumë vështirësi në ofrimin e shërbimeve direkte sipas nevojave të klientit. Për shkak të kufizimit të grumbullimeve, testimi i pajisjeve të reja që disa kompani ofrojnë, që do të sillte lehtësim shërbimesh, është i pamundur. Vështirësi të tjera janë të lidhura me pagat e punonjësve dhe sigurimet, ndërkohë që nuk punohet, shtyrja e kredive, nevoja për shtyrjen e afateve të kontratave, pamundësia për të shlyer pagesat e qirave, ndërkohe që nuk prodhohet dhe nuk ka qarkullim likuiditeti.

Shumë prej kompanive të konsulencës ngrenë shqetësimin se po detyrohen, me kërkesë të klientëve të tyre, të komunikojnë shkurtime pozicionesh pune në kompanitë që kanë përfaqësi në vend. Gjithë këto problematika, kanë sjellë krijimin e një klime paqëndrueshmërie dhe paniku mes përfaqësuesve të këtij sektori.

SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Kompanitë që ofrojnë shërbime të ndryshme për klientët e tyre, shprehen se situata e krijuar po sjell problematika serioze për ta, sidomos me kufizimin e lëvizjes është e vështirë që klientët e tyre të shkojnë në sportele. Përqendrimi i vizitave të klientëve në orare të përcaktuara, ka sjellë vështirësi në kryerjen e shërbimeve. Për pasojë, është e vështirë për të mbledhur detyrimet e klientëve për shkak të mungesës së likuiditetit.

Ndërkohë, bizneset detyrohen të vazhdojnë të paguajnë taksa, detyrime, pagesat e punëtorëve, qiratë apo çdo detyrim tjetër, gjë që po sjell një humbje të madhe në bilancet e këtyre kompanive dhe frikën për falimentim.

Kjo situatë po krijon ankth dhe panik mes biznesmenëve, pasi situata shfaqet e vështirë dhe e paparashikueshme, në këto kushte, nuk po arrihet të bëhet një planifikim për mënyrën sesi do të mund të rimëkëmben bizneset.

PRODHIMI DHE TREGTIA

Kompanitë e sektorit të prodhimit dhe tregtisë, po hasin problematika të rënda gjatë situatës së krijuar në vend dhe më gjerë, për të parandaluar përhapjen e virusit COVID 19.

Këto kompani shprehen se

kanë paralizuar pothuajse deri në mbyllje aktivitetet e tyre. Si pasojë e kufizimit të qarkullimit me automjete, këto biznese kanë probleme me furnizimet me lëndë të parë dhe më tej me shitjen e produkteve të tyre, inventarëve të mbetur gjendje që rrezikojnë të skadojnë apo të prishen, duke rritur kostot e biznesit.

Si pasojë e prishjes së këtij zinxhiri, është e vështirë të qarkullojë likuiditeti, të kryhen pagesat e qirave, pagat dhe sigurimet e punonjësve, pagesat e kredive dhe detyrimet që bizneset kanë pranë institucioneve publike apo private. Kompanitë që ofrojnë shërbime fasonerie po hasin shumë probleme me shitjen e mallrave që ato prodhojnë, me anulimin e porositve si pasojë e kufizimit të lëvizjes mes shteteve, por edhe të lëvizjes brenda vendit.

Problematika të ngjashme me kufizimin e lëvizjeve kanë dhe kompanitë, të cilat shesin dhe riparojnë automjete. Kompanitë e kësaj fashe kanë shprehur vazhdimisht problematikën që kanë si pasojë e inkurajimit që i bëhet importit të makinave të përdorura, duke ofruar pagesa shumë të ulëta doganore, pa marrë parasysh problematikën që këto automjete shfaqin si pasojë e përdorimit për një periudhë të gjatë kohore. Shërbimet e riparimit të makinave janë mbyllur për shkak të kufizimit të lëvizjes dhe pse për paradoks, kompanitë e këtij sektori janë

lejuar të punojnë sipas udhëzimeve të qeverisë.

Kompanitë e sektorit të prodhimit dhe tregtisë shprehen se këto biznese janë alarmuar nga krijimi kësaj situatë krize jo vetëm brenda vendit, por edhe globalisht si dhe për problematika që mund të vijnë si pasojë e prishjes së zinxhirëve të ekonomisë apo bashkëpunimit ndërsëktorial. Është e nevojshme për këto biznese që të ndihmohen nga qeveria me ndihmë konkrete ekonomike, si edhe me një pasqyrë të qartë të situatës dhe deklarimin e kohës sa do të zgjasë kjo situatë.

AGROBIZNESI

Kompanitë e agrobiznesit, anëtarë të Dhomës Amerikane, kanë shprehur problematikën e tyre në lidhje me orarin e përcaktuar nga udhëzimet e qeverisë për të zhvilluar aktivitetin, duke e cilësuar të papërshtatshëm për aktivitetin e tyre. Përfaqësuesit e këtij sektori biznesi propozojnë orarin 7.00 - 15.00, si orar të përshtatshëm për punimet në agrikulturë.

Gjithashtu, përfaqësues të këtij sektori janë të shqetësuar në lidhje me shkurtime drastik të fuqisë punëtore si dhe pasojat që kjo sjell. Ata shprehin vështirësi në shlyerjen e pagesave dhe sigurimeve shoqërore të punonjësve, duke qenë se aktiviteti i punës së tyre është reduktuar ndjeshëm.

Është e nevojshme, sipas përfaqësuesve të këtij sektori, shtyrja minimalisht me 3 muaj

kohë e kredive që këto biznese kanë pranë bankave të nivelit të dytë, duke propozuar shpërndarjen e këtyre detyrimeve në muajt në vazhdim.

Nga data 1 janar 2019, këto biznese po përballen me një taksim atipik që konsiston me taksimin 6 për qind për blerjen e lëndës së parë dhe taksim 20 për qind në shitje, i cili po e rëndon së tepërmi, deri në asfiksion, aktivitetin e bizneseve të këtij sektori.

BURIME NATYRORE

Bizneset në sektorin e minierave, nxjerrjes dhe shfrytëzimit të kronit që i janë përgjigjur pyetësorit, shprehen të shqetësuar për krizën që kjo periudhë po sjell në firmosjen e kontratave të reja për eksportimin e mineralit të nxjerrë. Si çdo sektor tjetër i ekonomisë në Shqipëri, edhe biznesmenët e këtij sektori shprehen të shqetësuar për të ardhmen e bizneseve të tyre.

ENERGJI

Kompanitë që ofrojnë shërbime në sektorin e energjisë, shprehen se kanë probleme serioze që lidhen me mungesën e personelit që këto kohë duhet të ishte operativ. Kjo sjell problematikë në kryerjen e shërbimeve apo veprimeve të tjera që lidhen me proceset e punës. Anullimi i porositve nga klientët të huaj, ka sjellë probleme serioze në pasqyrat financiare të këtyre kompanive. Shqetësim sjell edhe ulja e ndjeshme e

REKOMANDIMET E ANËTARËVE TË DHOMËS AMERIKANE PËR MASAT QË DUHET TË NDERMARRË QEVERIA:

- » Reduktimi ose eliminimi i përgjegjësiwe fiskale gjatë kësaj kohe;
- » Ndihmë për pagat e punonjësve;
- » Ulja ose eliminimi i pagesave fiskale të planifikuara për vitin 2019;
- » Miratimi i një liste masash, që do t'i lejojë punëtorët të kthehen në punë (*veshje mbrojtëse, distanca minimale, etj.*);
- » Lejimi i bizneseve që ofrojnë shërbime të rihapen;
- » Ndihmë në krijimin e një fondi, për të ndihmuar biznesin të mbetet likuid, duke siguruar kredi me interes zero;
- » Mbatja në pritje e të gjitha pagesave të kredisë, për të gjithë punonjësit që humbasin punën e tyre ose nuk paguhet gjatë kësaj periudhe;
- » Veprimet e Qeverisë duhet të ndahen në veprime specifike dhe të bëhen publike;
- » Programet e përcaktuara nga Qeveria, nuk duhet të ndryshojnë aq shpesh dhe afati kohor duhet të rritet në më shumë orë në ditë;
- » Koordinim më i mirë midis institucioneve qeveritare;
- » Nuk duhet të ketë diskriminim nga ana e Qeverisë për madhësinë e biznesit;
- » Testime masive të popullsisë, njerëzit e shëndetshëm duhet të lejohen që të shkojnë në punë.

çmimit të naftës. Kompanitë e këtij sektori janë të shqetësuar për pasojat që kjo krizë do të sjell në biznes.

ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

Organizatata jofitimprurëse dhe ato me subjekt të veprimtarisë së tyre aktivitetet e bamirësisë, kanë ngritur shqetësim me problematikën që ka sjellë në implementimin e projekteve të tyre brenda afateve, si pasojë e kufizimit të qarkullimit dhe nevoja për reduktimin e kapitalit njerëzor në dispozicion, për arsye të nevojës për reduktimin e ekspozimit me qëllim shmangien e infektimit nga virusi COVID 19.

Plani Financiar

MASAT EKONOMIKE TË NDËRMARRA DHE AKTET PËRKATËSE NORMATIVE

Akti Normativ Për Disa Ndryshime dhe Shtesa Në Ligjin Nr.88/2019 "Për Buxhetin e Vitit 2020" miratoi 7 masa ekonomike si më poshtë:

- » **100 milionë dollarë** alokohen përmes një **garancie sovranë për kompanitë që kanë vështirësi** të arsyetuara për të paguar punonjësit.
 - » **65 milionë dollarë** për nevojat më urgjente për:
 - a. Shtresat më në nevojë;
 - b. Biznesin e vogël;
 - c. Papunësinë e mundshme për shkak të gjendjes.
 - » Fshihen përgjithmonë kamatvonesat për debitorët aktivë, familjarë apo biznesi në vogël.
 - » **Shtyhet në 6 mujin e dytë të 2020 dhe në vazhdim, tatim-fitimi për biznesin e vogël.**
 - » **Shtyhet dorëzimi i bilanceve** për një periudhë deri në 1 qershor të këtij viti për **bizneset që dorëzojnë bilancet në QKB online ose drejtëpërdrejtë.**
 - » 25 milionë dollarë për Ministrinë e Shëndetësisë, për materiale dhe mbështetje të stafëve mjekësore;
 - » 20 milionë dollarë për Ministrinë e Mbrojtjes, për Operacionin Humanitar.
 - » 10 milionë dollarë, si fond rezervë për Këshillin e Ministrave.
- *UDHËZIMET përkatëse për zbatimin e këtij Akti Normativ nuk janë publikuar ende.*

SHTYRJA E AFATIT TË DEKLARIMIT TË BILANCIT KONTABËL DHE PAGIMIT TË TATIM-FITIMIT

- » **Bilanci kontabël me anekset e tij dorëzohet brenda datës 31 korrik 2020;**
- » Për biznesin e vogël, **tatimi i llogarit në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme** paguhet brenda **gjashtë muajit të dytë 2020.**
- » Për biznesin e vogël, **këstet e tatim-fitimit të tremujorit të parë dhe të dytë të 2020-ës,** parapaguhet brenda datës **31 dhjetor 2020.**
- » Këstet e **tatimit mbi fitimin, të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020,** parapaguhet në llogarinë e organeve tatimore, brenda datës **31 dhjetor 2020.**
- » Tatimpaguesit me përgjegjësi të tatimit më Tatum i Thjeshtuar mbi Fitimin me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kryhen:
 - d. për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020 brenda datës 20 tetor 2020;
 - e. për tremujorin e tretë dhe të



katërt të vitit 2020 brenda datës 20 dhjetor 2020.

REFERENCA:

Akti Normativ Nr.10, datë 26.3.2020 Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", të ndryshuar - Gjej këtu.

Akti Normativ Nr. 11, datë 27.3.2020 Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar - Gjej këtu.

Për përmbajtjen e plotë të njoftimit të DPT kliko këtu.

2 NDIHMA FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË BIZNESIN E VOGËL

Kushtet që bizneset të aplikojë:

- » për vitin 2019 të kenë realizuar të ardhura deri në 14 milionë lekë;
- » të kenë ndërprerë aktivitetin gjatë periudhës së COVID-19.

Përfutjes të ndihmës financiare janë:

- » personat fizikë të vetëpunësuar;
- » punonjësit e paguar të familjes të personit fizik tregtar;
- » të punësuarit në personat fizikë tregtarë.

» të punësuarit në personat juridikë

**Ndihma financiare, është e barabartë me pagën minimale në fuqi, 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë.*

Procedura:

Subjektet duhet të plotësojnë një formular që depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke filluar nga data 1 PRILL me këto të dhëna:

- » Të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NUIS
- » Të dhënat identifikuese të përfutjesve, përfshirë të vetpunësuarit, punonjësit e paguar të familjes dhe të punësuarit: - emrin, atësinë, mbiemrin - numrin personal të identifikimit të individit - bankën ku përfutjesi ka llogarinë rrjedhëse bankare - IBAN të llogarisë bankare të individit përfutjes

Gjej Vendimin dhe Aktin Normativ përkatës këtu.

3 VENDIME TË TJERA TË KARAKTERIT FINANCIAR

VENDIMI E KËSHILLIT MBIKËQYRËS I DATËS 12 MARS 2020 i krijon lehtësi bankave, subjekteve financiare jo banka dhe shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre për periudhën Mars - Maj 2020 që në rastet kur evidentohen paafësi paguese të kredimarrësve të mos jenë subjekt i zbatimit të kërkesave të rregulloreve. - Gjeni Aktin Normativ përkatës këtu.

» URDHËRI I PËRBASHKËT I KRYEMINISTRIT DHE GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR SHTYRJEN ME 3 MUJ TË AFATIT TË PAGIMIT TË KËSTEVE TË KREDIVE vendosi:

- f. Shtyhet afati i kësteve të kredive deri në datën 31.05.2020 për biznese dhe individë të cilët janë përballur më vështirësi si pa-

sojë e COVID-19;

g. Kredimarrësit duhet të argumentojnë tek kredidhënësit arsyet mbi nevojat e tyre për shtyrje të pagimit të kësteve. Institucionet e kreditimit do të bëjnë procesimin e çdo kërkesë të paraqitur pranë tyre brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Gjej Urdhërin e Përbashkët këtu.

4 NJOFTIME TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Informacion mbi mundësinë e pagesës së detyrimeve tatimore nëpërmjet portalit e-albania si dhe online-banking në bankat e nivelit të dytë; - Gjej Aktin Normativ këtu.

Mbi procedurën që duhet ndjekur për autorizimin e qarkullimit të punonjëseve të kompanive dhe sipërmarrjeve të prodhimit - Gjej Aktin Normativ këtu.

Lista e aktivitetëve që do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe aktivitetet të cilat do të ndalohen të ushtrojnë aktivitetin ekonomik duke filluar nga data 24 Mars 2020. - Gjej Aktin Normativ këtu.

MASA ADMINISTRATIVE

AKT NORMATIV "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19"

Ky akt normativ ka për qëllim përcaktimin e masave administrative (gjyba) në kuadër të forcimit të zbatimit të rregullave dhe vendimeve të organeve kompetente për përballimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19. - Gjej Aktin Normativ të plotë këtu dhe aktin administrativ shtesë këtu dhe këtu.

5 VEPRIMTARIË GJYQËSORE

AKT NORMATIV Nr.9, DATË 25.3.2020 "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË FUSHËN E VEPRIMTARISË GJYQËSORE, GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19" vendosi:

Pezullohen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë Covid-19:

- » Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile, penale pranë çdo gjykate.
 - » Afatet për ngritjen e padive, paraqitjen e ankimeve dhe kryerjen e çdo veprimi procedural.
- Gjeni përmbajtjen e plotë të aktit këtu.



10 propozimet e Bashkimit të Prodhuësve: Pagat të subvencionohen 80%, taksat vendore të shtyhen deri në dhjetor 2020, të ulet çmimi i energjisë

– *Monitor.al*

Paketa e Bashkimit të Prodhuësve, në mbështetje të sektorit, propozon si masë lehtësuese, subvencionimin nga shteti për 9 javë të 80% të pagës të punonjësve. Prodhuësit shprehën se në paketën e qeverisë, duhet të përfshihen edhe bizneset që kanë reduktim mbi 25 % të xhiros. Sipërmarrja prodhuese kërkon edhe shtyrjen deri në fund të vitit të tarifave dhe taksave vendore, parapagimin e tatimit për 2020-ën, si dhe përgjysmimin e çmimit të energjisë për 3 muaj.

Rama: Papunësia do të rritet, qeveria e përgatitur për ndërhyrje. Masat shtrënguese deri në 2 javë e para të prillit

– *Monitor.al*

"Kemi filluar me ata që janë më të dobët dhe me masat që kemi marrë janë për ekzistencë, jo për fitimet. Ashtu si në të gjithë botën, rritet trendi i papunësisë, sektori që ka nevojë për mbështetje si turizmi apo ndonjë tjetër. Biznesit të madh i kemi dhënë garanci sovraane që mund ta përdorë për të paguar punonjësit. Po ndjekim me shumë vëmendje lëvizjet që po bën biznesi i mesëm dhe i madh, për njerëzit që po dalin të papunë. Jemi të përgatitur për të bërë një ndërhyrje kur të jetë momenti", tha Rama.

Tatimet u kujtojnë bizneseve të bëjnë sot pagesën e tatimit fitimit (2019)

– *Monitor.al*

Drejtoria e Tatimeve u ka sjellë dje në vëmendje tatimpaguesve se afati i dorëzimit të deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin për vitin fiskal 2019, është data 31 mars 2020. Për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milion lekë, afati i pagesës së Tatimit të llogarit pakësuar me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore është data 31 mars.

176 mijë të punësuar në biznesin e vogël, lista e aktiviteteve që

përfitojnë nga buxheti

– *Monitor.al*

Janë rreth 99 mijë subjekte në vend, të cilat janë të regjistruara si biznes i vogël, pra që kanë një qarkullim vjetor deri në 14 milion lekë, ose rreth 92% e totalit të ndërmarrjeve në vend. Sipas të dhënave nga tatimet, në këto subjekte të vogla deri në fund të vitit 2019 ishin të punësuar gjithsej rreth 176 mijë persona, si të vetëpunësuar, apo të punësuar me pagë.

Zhvillimi i tregjeve të kapitalit, Pr.Ligji në Kuvend/ Mundësi financimi dhe transparencë në investime

– *Scan TV*

Projektligji i hartuar nga Ministria e Financave për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, është finalizuar pas thuasë një viti dhe depozituar në komisionet parlamentare për t'i hapur më tej rrugë miratimit të tij.

Legalizimi i kriptomonedhave/ Nisin procedurat e miratimit të

ligjit në Kuvend

– *Scan TV*

Projektligji që synon të ligjërojë përdorimin e kriptomonedhave në Shqipëri ka nisur procedurat e miratimit në Kuvendin e Shqipërisë. Dokumenti në fjalë u prezantua nga qeveria shqiptare në tetor të vitit të kaluar dhe do ta bëjë Shqipërinë një ndër vendet e para që e rregullon me ligj tregtimin e kriptomonedhave.

Azia Lindore dhe Paqësori: Vendet duhet të veprojnë tani për të zbutur goditjen ekonomike të COVID-19

– *The World Bank*

Në një mjedis që ndryshon me shpejtësi, bërja e parashikimeve të rritjes së saktë është jashtëzakonisht e vështirë. Prandaj, raporti paraqet një bazë fillestare dhe një skenar të çështjeve më të ulëta.

LAJME SHKURT

PEZULLOHEN TENDERAT / APP: Prokurimet Publike, vetëm për nevojat në luftën "kundër" COVID-19

Përmes një njoftimi zyrtar Agjencia e Prokurimit Publik ka pezulluar çdo procedurë tenderuese që nuk ka të bëjë me situatën e krijuar për shkak të koronavirusit.



Euro zbrit në 128.5 lekë, pas rritjes artificiale të dy javëve të fundit, por diferenca në shit-blerje mbetet e lartë

Monedha e përbashkët ka shënuar sërish rënie sot në tregun valutor për të dytën ditë radhazi. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, një euro u këmbye sot me 128.52 lekë, me një rënie prej 2.14 lekë në raport me ditën e mëparshme. Nga dita e hënë, kur euro arriti në rekordin e 2 viteve, duke u këmbyer me 131.06 lekë, euro ka rënë me 2.5 lekë.

Tregu i sigurimeve, rritje para Corona-virusit, dyfishohet pagesa e dëmeve

Tregu i sigurimeve ka paguar dy herë më shumë dëme për periudhën janar – shkurt 2020 krahasuar me një vit më parë, si pasojë e dëmeve nga tërmetet e 21 shtatorit dhe 26 nëntorit të vitit të kaluar. Kjo situatë duhet theksuar se është para fillimit të masave të karantinës dhe kufizimit të lëvizjeve për shkak të koronavirusit, çka pritet të ngadalësojë ndjeshëm tregun e sigurimeve për muajt mars e në vijim.